




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIJA KUNDER KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	DPKI
Dep.	06-02-3104/22
Dep.	28.07.2022
Nr. I faq	
Broj stranice	
PRISHTINE	



Republika e Kosovës 28.07.2022
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIJA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nëparag. 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nëparag. 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit, me datë 20.07.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I. Mbyllt rasti AKK-DPKI-06-2605/21, për zyrtarin e lartë z. Enver Hoxhaj, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak se ështëshmangur gjendja e konfliktit të interesit përkatesisht papajtueshmërisë me ushtrimin të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Enver Hoxhaj, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: LPKI).

Ky rast ka filluar të trajtohet pasi është identifikuar se z. Enver Hoxhaj, krahas ushtrimit të funksionit publik Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, është përfaqësues i autorizuar dhe mban funksion drejtues (Drejtor) në OJQ “Kosova Documentation Institute / Instituti për Dokumentim i Kosovës”.



Fillimisht, Agjencia kundër Korrupsionit, me qëllim të verifikimit të gjendjes së papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, ka kërkuar informatat për OJQ-në në fjalë, nga Departamenti për OJQ në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Nga përgjigja e pranuar prej Departamentit për OJQ (shkresa zyrtare: DPKI-06-2605/21), zyrtari në fjalë figuron të jetë përfaqësues i autorizuar - drejtor i OJQ-së si më lart.

Agjencia kundër Korrupsionit, me shkresën zyrtare DPKI-06-02/2446/22, e ka njoftuar zyrtarin e lartë lidhur me fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit dhe më pas e ka njoftuar lidhur me faktet për rastin, si dhe ka udhëzuar për veprimet që duhet t'i ndërmerr për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit përkatesisht papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionin publik.

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të jetë përfaqësues i autorizuar në organizata joqeveritare, për faktin se një situatë e tillë paraqet papajtueshmëri me ushtrimin e

funkcionit publik, përkatësish gjendje të konfliktit të interesit. Kjo ndalohet me dispozitën e nenit 13, paragrafi 1 të LPKI-së, ku përcaktohet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksioni”.

Përveç kësaj, zyrtari i lartë nuk mundet që, njëkohësisht me ushtrimin e funksionit publik, të mbajë funksion drejtues në OJQ, sepse kjo situatë është në kundërshtim me nenin 14 paragrafi 1, të LPKI-së, i cili përcakton se:

“Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërbllimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe të tjera të lidhura me to”.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korruptionit ka pranuar informatën (DPKI-06-02/2446-1/22), se zyrtari i lartë ka bërë ndryshimet e nevojshme duke shuar OJQ-në “Kosova Documentation Institute / Instituti për Dokumentim i Kosovës”.


Pas analizimit të informatave si më lartë, Agjencia kundër Korruptionit konstatoi se zyrtari i lartë z. Enver Hoxhaj, ka shuar në tërësi OJQ-në si më lartë, e rrjedhimisht nuk mban më ndonjë funksion drejtues apo përfaqësues të kësaj OJQ-je, sikurse parashihet me nenin 19 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3, të LPKI-së. Në këtë mënyrë, Agjencia konstatoi se me veprimet që i ka ndërmarrë zyrtari i lartë, ështëshmangur gjendja e konfliktit të interesit përkatësish papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11, të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit, Agjencia mund të rihapë rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)


Yll Buleshkaj

Drejtor i Agjencisë kundër Korruptionit